

**Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e
Legjislacionit Mjedisor**

Një projekt për Shqipërinë financuar nga Bashkimi Evropian

Projekt Vendim
për Formatin e Njoftimeve
që kërkohen nga Ligji për Kontrollin e Rreziqeve nga Aksidentet
Industriale Madhore që shkaktohen nga substance të rrezikshme*

DRAFT 2 Version 1

07.06.2011

* Ky vendim zbaton Direktivën 96/82/EC për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që shkaktohen nga substanca të rrezikshme, amenduar me Rregulloren EC/1882/2003, Direktivën 2003/105/EC dhe Rregulloren EC/1137/2008, përsa i përket Njoftimeve



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

DRAFT 2 Version 1

07.06.2011

VENDIM

Nr _____, datë _____

**PËR FORMATIN E NJOFTIMEVE QË KËRKOHEN NGA LIGJI PËR
KONTROLLIN E RREZIQEVE NGA AKSIDENTET INDUSTRIALE
MADHORE QË SHKAKTOHEN NGA SUBSTANCA TË RREZIKSHME (1)**

Në mbështetje të Nenit 59 paragrafi 1.d dhe 100 të Kushtetutës dhe Nenit 7 të Ligjit nr _____, datë _____ “Për Kontrollin e Rreziqeve nga Aksidentet Madhore”, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Të miratojë formatin që operatori i ndërmarrjes duhet të përdorë në Njoftimin që i dërgon Autoriteteve Kompetente në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit “Për Kontrollin e Rreziqeve nga Aksidentet Industriale Madhore që shkaktohen nga substance të rrezikshme”.
2. Për qëllime të këtij Vendimi, të gjitha termat e përdorur kanë kuptimin e dhënë nga Neni 2 i Ligjit “Për Kontrollin e Rreziqeve nga Aksidentet Industriale Madhore që shkaktohen nga substance të rrezikshme”.
3. Në rastet kur, në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit, operatorët e ndërmarrjes ku gjen zbatim Rregullorja, duhet të informojnë Autoritetin Kompetent për sasinë dhe formën fizike të substancave të rrezikshme të pranishme në ndërmarrje, ata përdorin formularin në Aneksin bashkangjitur këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

* Ky vendim transponon Direktivën 96/82/EC për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që shkaktohen nga substanca të rrezikshme, amenduar me Rregulloren EC/1882/2003, Direktivën 2003/105/EC dhe Rregulloren EC/1137/2008, përsa i përket Njoftimeve

Aneks

Njoftimi – Pjesa A

Ky informacion do të vendoset në Regjistrin Publik

Emri dhe adresa e operatorit (*shihni Shënimin 1*)

--

Adresa e ndërmarrjes (*nëse e ndryshme nga më sipër*)

--

Emri dhe pozicioni i personit përgjegjës për ndërmarrjen

--

Informacion i mjaftueshëm për identifikimin e substancave të rrezikshme të pranishme. Sasia dhe forma fizike e substancave të rrezikshme të pranishme. (*Shihni Shënimin 2*)

--

Informacion i mjaftueshëm për identifikimin e kategorive të substancave të rrezikshme të pranishme. Sasia dhe forma fizike e substancave të rrezikshme të

pranishme (shihni Shënimet 2 dhe 3)

Përshkrimi i aktivitetit ose aktiviteti i propozuar i instalimit në fjalë (shihni shënimin 4)

Detaje të elementeve të mjedisit të afërt që kanë mundësi të shkaktojnë aksident madhor apo të përkeqësojnë pasojat e aksidentit madhor (shihni Shënimin 5)

Arsyeja për këtë Njoftim

A keni dorëzuar më parë njoftim për këtë ndërmarrje?

PO

JO

Nëse PO, jepni datën e dorëzimit dhe Numrin e Protokollit të Autoritetit Kompetent

Pse po e dorëzoni këtë njoftim? (ju lutemi vendosni shenjën \checkmark në kutinë e duhur)

Përpara fillimit të ndërtimit të një ndërmarrje të re (Neni 7.1)

Përpara fillimit të operimit të një ndërmarrje të re (Neni 7.2)

Ndërmarrja është një ndërmarrje ekzistuese (Neni 7.3)

Rritje e konsiderueshme në sasinë e substancave të rrezikshme (Neni 7.5(a))

Ndryshim i konsiderueshëm në natyrën ose formën e substancave të rrezikshme, proceseve që i përdorin ato apo çdo lloj tjetër informacioni të njoftuar më parë (Neni 7.5(b))

Pakësimi i sasisë së substancave të rrezikshme nën pragun e nivelit më lartë (Neni 7.5(c))

	Modifikimi i ndërmarrjes ose një instalimi të saj që mund të ketë pasoja të konsiderueshme për rrezik për aksidente madhore (Neni 7.5(d))
	Mbyllja e përhershme e një instalimi në ndërmarrje (Neni 7.5(e))

A dëshironi të përjashtohet ndonjë informacion nga regjistrat publikë për arsye se është konfidencial nga ana komerciale apo personale? (*shihni Shënimin 6*)

PO	Duhet të plotësoni Pjesën A të formularit duke përjashtuar informacionin konfidencial nga ana komerciale apo personale; Më pas duhet të plotësoni Pjesën B të formularit duke përfshirë informacionin konfidencial nga ana komerciale apo personale dhe të jepni justifikim për përjashtimin e tij nga regjistrat publikë
JO	Duhet të plotësoni Pjesën A të formularit

Deklaratë

Vërtetoj se informacioni në Pjesën A është i saktë.

Emri	
Firma	
Data	

Njoftimi i plotësuar të dërgohet nw:

Adresa e Autoritetit Kompetent

Autoriteti Kompetent do të konfirmojë marrjen e tij brenda 10 ditë pune.

Njoftim – Pjesa B

Ky informacion nuk duhet të publikohet në Regjistrin Publik

Emri dhe adresa e operatorit

Adresa e ndërmarrjes (nqse është e ndryshme nga më sipër)

Siguria Kombëtare

A ka ndonjë informacion që besoni se duhet përjashtuar nga regjistri publik për arsye të sigurisë kombëtare?

PO	<input type="checkbox"/>
JO	<input type="checkbox"/>

A është marrë një vendim nga Ministri i **[cili ministër?]**

PO	<input type="checkbox"/>
JO	<input type="checkbox"/>

Nqse po, ju lutem jepni numrin dhe datën e vendimit

A përmban pjesa A e formularit të njoftimit ndonjë informacion për sigurinë kombëtare që do ta pengonte atë për tu vendosur në regjistrin publik?

PO	<input type="checkbox"/>
JO	<input type="checkbox"/>

Konfidencialiteti Komercial dhe Personal

A dëshironi të përjashtohet ndonjë informacion nga regjistrat publikë për arsye se është konfidencial nga ana komerciale apo personale?

PO	<input type="checkbox"/>
JO	<input type="checkbox"/>

Nqse PO, atëherë duhet:

Të plotësoni Pjesën A duke përjashtuar informacionin konfidencial komercial apo personal.

Të plotësoni Pjesën B duke përfshirë informacionin konfidencial komercial apo

personal dhe të jepni justifikimin për përjashtimin e tij nga regjistri publik në kutinë më poshtë.

--

Deklaratë

Vërtetohet se informacioni në Pjesën B të njoftimit është i saktë.

Emri	
Firma	
Data	

Shënime

1. Përfshini adresën e regjistruar të zyrës
2. Forma fizike përfshin gazet, lëngjet, pluhurat dhe trupat e ngurtë. Sasia është sasia maksimale që mund të parashikohet se do të jetë e pranishme.
3. Jepni informacion që identifikon emrat dhe kategoritë e substancave të rrezikshme (p.sh. toksike ose të djegshme – shihni Aneksin 1, Pjesa 2 e Ligjit). Magazinat apo ndërmarrjet e tjera me ndryshime të shpeshta të inventarit mund të njoftojnë kufijtë tavan të kategorive të përgjithshme.
4. Jepni një përshkrim të shkurtër të aktivitetit apo aktivitetit të propozuar (p.sh. prodhim i plehërave të nitrat amonit).
5. Përshkruani ndërmarrjet apo karakteristikat e mjedisit që mund të çonte në një aksident madhor në territorin tuaj. Përshkruani elementët e mjedisit rrethues që mund të përkeqësonin pasojat e një aksidenti madhor (p.sh. shtëpitë e afërta, ndërtesat e tjera të zëna, parqet natyrore, bujqësinë apo prodhimin e ushqimeve, punimet për ujërat e zeza, ujërat sipërfaqësorë që përdoren për nxjerrjen e ujit të pijshëm).
6. Nëse dëshironi të paraqisni një kërkesë për konfidencialitetin komercial apo personal atëherë këshillohet që të kontaktoni Autoritetin Kompetent përpara dorëzimit të këtij Njoftimi. Kur bëhet një kërkesë për konfidencialitet, Autoriteti Kompetent merr vendim brenda 28 ditësh dhe ju informon për rezultatin.